



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 104

24 qershor

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Udhëzim i MMPAU nr. 1, datë 6.3.2013	Për mënyrat e shënimit të kufijve të zonës së gjuetisë..... 4591
Udhëzim i MF nr. 19, datë 17.6.2013	Për shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 4, datë 19.1.2009 “Për përcaktimin e fondit të ngurtësimit për garancinë e fituesit/fituesve në lojërat e fatit”..... 4591
Urdhër i MMPAU nr. 283, datë 10.4.2013	Për miratimin e listës së sipërfaqeve ligatinore bregdetare, që shërbejnë si habitate për shpendët migratorë..... 4594
Vendim i BSH nr. 33, datë 30.4.2013	Për miratimin e udhëzimit “Mbi administrimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës”..... 4597
Vendim i AMA nr. 4, datë 22.5.2013	Mbi miratimin e pagesave për licencë..... 4612
Vendim i AMA nr. 5, datë 22.5.2013	Mbi miratimin e pagesave për autorizim..... 4613
Vendim i AMA nr. 6, datë 22.5.2013	Mbi miratimin e pagesave për shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive..... 4618
Kërkesë e MPPT nr. 2315/7 datë 13.6.2013	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Përmirësimi i sistemit të kanalizimit të Tiranës së madhe”..... 4619
	Vendim për shpalljen të zhdukur të shtetasit Aurel Starova..... 4626

UDHËZIM
Nr. 1, datë 6.3.2013

PËR MËNYRAT E SHËNIMIT TË KUFIJVE TË ZONËS SË GJUEISË

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 15 të ligjit nr. 10 253, datë 11.3.2010 “Për gjuetinë”,

UDHËZOJ:

1. Mbështetur në hartën e zonës së gjuetisë, menaxhuesi i zonës së gjuetisë, në bashkëpunim me drejtorinë e shërbimit pyjor përkatës, vendosin në terren shenjat dalluese të kufijve të zonës së gjuetisë, bazuar në kufijtë e përcaktuar në hartë.

2. Shenjat dalluese do të jenë prej materiali drusor të stazhionuar, me formë katërkëndëshe, me lartësi mbi tokë 1.5 m, lyer me bojë të verdhë, në faqet e së cilës shënohet emri i zonës së gjuetisë.

3. Vendosja e shenjave të bëhet në pikat më dominuese dhe më të dukshme përgjatë kufirit të zonës.

4. Distanca midis dy shenjave vijuese të jetë më e madhe se 500 m.

5. Prodhimi i shenjave dalluese do të bëhet në mënyrë të përqendruar në drejtorinë e shërbimit pyjor, nga lënda që del nga trajtimi i pyjeve.

6. Menaxhuesi i zonës së gjuetisë, në bashkëpunim me drejtorinë e shërbimit pyjor, përgjigjen për ruajtjen e mosdëmtimin e këtyre shenjave.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI MJEDISIT, PYJEVE DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Fatmir Mediu**

UDHËZIM
Nr. 19, datë 17.6.2013

**PËR SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 4, DATË 19.1.2009 “PËR
PËRCAKTIMIN E FONDIT TË NGURTËSIMIT PËR GARANCINË E
FITUESIT/FITUESVE NË LOJËRAT E FATIT”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 42 të ligjit nr. 10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 4, datë 19.1.2009 “Për përcaktimin e fondit të ngurtësimit për garancinë e fituesit/fituesve në lojërat e fatit”, bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si vijon:

1. Për çdo sallë bingo, organizatori duhet të garantojë, për çdo lojë, fituesin/fituesit e lojërave të fatit, me kapitalin themeltar të shoqërisë, si dhe me fondin e ngurtësimit:

a) Për sallat në rrethet e kategorisë së parë, në masën 2 000 000 (dy milionë) lekë;



b) Për sallat në rrethet e kategorisë së dytë, në masën 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

c) Për sallat në rrethet e kategorisë së tretë, në masën 1 000 000 (një milion) lekë.

Organizatori mund të kërkojë çngurtësimin e pjesshëm për shumën e fondit të garancisë për fituesit, në përputhje me përkatësinë e sallës me njërin nga kategoritë e parashikuara në pikat “a”, “b” apo “c”.

2. Në fund të pikës 4 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Për kazinotë elektronike në distancë, fondi i ngurtësimit të jetë në masën 200 000 000 (dyqind milionë) lekë.”.

3. Në fund të pikës 5 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Në rast se shoqëria, edhe pse e ka bllokuar fondin e garancisë, nuk është pajisur me leje, zhbllokimi i këtij fondi bëhet nga Ministri i Financave pas propozimit të NJMLF-së.”.

4. Në fund të pikës 6 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Për kazinotë elektronike në distancë, garancia duhet të jetë sipas formatit bashkëlidhur këtij udhëzimi si pjesë përbërëse e tij.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCVE
Ridvan Bode

**FORMULARI I GARANCI BANKARE PËR KAZINOTË ELEKTRONIKE NË
DISTANCË**

Nr. ref. _____

Data _____

Për : Ministrinë e Financave
Adresa:

Duke qene se kompania _____ ka marrë persiper në bazë të ligjit të ligjit nr.10033, datë 11.12.2008 "Për lojërat e fatit", i ndryshuar, të organizojë lojë fati të llojit "Kazino elektronike në distancë";

Duke qene se ne bazë përcaktimeve të ligjit nr.10033, datë 11.12.2008 "Për lojërat e fatit", i ndryshuar, kerkohet Garanci Bankare në shumen e specifikuar në të, si fond i ngurtësuar për garantimin e fituesit/fituesve të lojës së fatit;

Duke qene se (emri dhe adresa e Bankes) është dakord të leshojë këtë garanci :

Deklarojmë se ne jemi garantuesit e garancisë së mësipërme deri në shumën totale prej - 200.000.000 lek (*dyqind milion lekë*), shumë e cila është e pagueshme në formën, mënyrën dhe monedhën e përcaktuar në ligj.

Ne marrim përsiper të paguajmë, sapo të beni kërkesën e parë me shkrim dhe pa qene nevoja të bëni argumentim të kërkesës, çdo shumë brenda kufirit prej 200.000.000 lek (*dyqind milion lek*).

Me kete garanci ju sigurojme se nuk është nevoja t'i drejtoheni më parë kompanisë _____ për të realizuar pagesen sipas kërkesës suaj.

Deklarojme gjithashtu, se asnje shtesë apo ndryshim i kushteve të ligjit, nuk na çliron nga detyrimet e kesaj Garancie, pa një urdhër zhbllokimi të lëshuar nga Ministri i Financave.

Nenshkrimi dhe Vula e Bankes



URDHËR
Nr. 283, datë 10.4.2013

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË SIPËRFAQEVE LIGATINORE BREGDETARE, QË
SHËRBEJNË SI HABITATE PËR SHPENDËT MIGRATORË**

Në bazë të nenit 102 të Kushtetutës, nenit II dhe III.3/b të Konventës së Bonit “Për mbrojtjen e llojeve migratore të faunës së egër”, në të cilën Shqipëria ka aderuar me ligjin nr. 8692, datë 16.11.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Bonit “Për mbrojtjen e llojeve shtegtuese të kafshëve të egra” dhe mirëkuptimet e kësaj Konvente”, të pikave 4 e 8 të nenit 13 të ligjit nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” dhe të pikës 1/ë të nenit 11 të ligjit nr. 10 253, datë 11.3.2010 “Për gjuetinë”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e listës së sipërfaqeve ligatinore bregdetare, zona me rëndësi për shpendët *Important Bird Areas (IBA)* që shërbejnë si habitate për shpendët migratorë, sipas shtojcave dhe hartës bashkëlidhur këtij urdhri si pjesë përbërëse e tij, me kufij:

a) Sipas atyre të përcaktuara në bazë të statusit mbrojtës të zonës në të cilën shtrihet ligatina, për ligatinat nga pika 1 deri në 8 të shtojcës;

b) sipas kufijve natyrorë të ligatinës, për ligatinën paraqitur në pikën 9 të shtojcës.

2. Sipërfaqet ligatinore bregdetare, sipas shtojcës të pikës 1, në përputhje me dispozitat e pikës 1/ë dhe 2 të nenit 11 të ligjit “Për gjuetinë”, në rast se janë përfshirë në zonat e gjuetisë të miratuara, duhet të përjashtohen si të tilla.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Biodiversitetit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe drejtoritë përkatëse të shërbimit pyjor.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI MJEDISIT, PYJEVE DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Fatmir Mediu**

Zonat ligatinore me te rendesishme per shpendet shtegtar
Most important Albanian Wetland Areas for Migratory Birds



Punoi Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerve
ne bashkepunim me ECAT Tiranen



CtyBirdLifeNa	SttRecID	SttNational	SttFinalCode	National Code	Temp Code	SttArea	SttAltMin	SttAltMax	SttLat	SttLong	DelDesc	SttIBASitCrIS	IBASStatus	KBASStatu	Responsibility	SubDesc	SttCrISumComplete	SttCrISumYear	SttCrISumProposed	SttCrISumConfirmed	SttCrISumA1	SttCrISumA2	SttCrISumA3	SttCrISumA4i	SttCrISumA4ii	SttCrISumA4iii	SttCrISumA4iv	SttCrISumNotes
Albania	2905	Delta e Drinit	AL007	AL004	AL007	2188	0	5	41.7833	19.6167	1. point	2904	confirmed	-	BirdLife	Lezhë, Shkodër	Y	2000		A1, A4i, B1i	C	N	N	C	N	N	N	
Albania	2912	Gjiri i Lalzit	AL015	AL006	AL016	800	0	0	41.3	19.5	1. point	2911	confirmed	-	BirdLife	Durrës	Y	2000		B1i	N	N	N	N	N	N	N	
Albania	2904	Laguna e Karavastase	AL006	AL008	AL006	5450	0	5	40.8833	19.4167	1. point	2903	confirmed	-	BirdLife	Fier, Lushnjë	Y	2000		A1, A4i, A4iii, B1i, B2	C	N	N	C	N	C	N	
Albania	2903	Laguna e Nartës	AL005	AL009	AL005	4180	0	5	40.58333333	19.38333333	1. point	2902	confirmed	-	BirdLife	Vlorë	Y	2000		A1, A4i, A4iii, B1i	C	N	N	C	N	C	N	
Albania	2911	Laguna e Patokut	AL014	AL005	AL015	1211	0	1	41.6333	19.6	1. point	2910	confirmed	-	BirdLife	Krujë	Y	2000		A1, A4i, B1i	C	N	N	C	N	N	N	
Albania	2910	Liqeni i Butrintit	AL012	AL011	AL013	1900	0	0	39.8333	20	1. point	2909	confirmed	-	BirdLife	Sarandë	Y	2000		B2	N	N	N	N	N	N	N	
Albania	2899	Liqeni i Shkodrës	AL001	AL002	AL001	14000	0	10	42.1667	19.3333	1. point	2898	confirmed	-	BirdLife	Shkodër	Y	2000		A1, A4i, A4iii, B1i	C	N	N	C	N	C	N	
Albania	2913	Velloja	AL013	AL003	AL014	1500	0	50	41.8667	19.4333	1. point	2912	confirmed	-	BirdLife	Shkodër	Y	2000		A1	C	N	N	N	N	N	N	
Albania	2908	Vlora Bay, Karaburun, Mali i Cikes	AL010	AL010	AL005-	35000	0	2018	40.1667	19.6667	1. point	2907	confirmed	-	BirdLife	Vlorë	Y	2000		B2	N	N	N	N	N	N	N	

VENDIM
Nr. 33, datë 30.4.2013

**PËR MIRATIMIN E UDHËZIMIT “MBI ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË NORMËS SË
INTERESIT NË LIBRIN E BANKËS”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe të neni 58 pika 1, shkronjat “b” dhe “c” të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes

VENDOSI:

1. Të miratojë udhëzimin “Mbi administrimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Europian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, udhëzimi “Mbi administrimin e rrezikut të normës së interesit”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 61, datë 5.7.2000, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit të tij në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

UDHËZIM
MBI ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË NORMËS SË INTERESIT NË LIBRIN E BANKËS

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i kërkesave dhe rregullave bazë për administrimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës, metodës së llogaritjes së ekspozimit ndaj këtij rreziku dhe raportimit në Bankën e Shqipërisë.

Neni 2
Subjektet

Subjekte të këtij udhëzimi janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të cilat ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me licencën e dhënë nga Banka e Shqipërisë (këtu e më poshtë në këtë udhëzim do të quhen “banka”).



Neni 3 **Baza juridike**

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe të nenit 58, pika 1, shkronjat “b” dhe “c” të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

Neni 4 **Përkufizime**

1. Termat e përdorur në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar sipas ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Përveç sa parashikohet në paragrafin 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “Rreziku i riçimit” është mundësia që banka të pësojë humbje financiare si rezultat i mospërputhjeve të maturitetit (për normat e interesit fikse) dhe i riçimit të normave të interesit (për normat e ndryshueshme të interesit) të pozicioneve të librit të bankës;

b) “Rreziku i kurbës së kthimit (*Yield*)” është mundësia që banka të pësojë humbje financiare si rezultat i ndryshimit të pjerrësisë së kurbës së kthimit/yield-it;

c) “Rreziku bazë (*Basis risk*)” është mundësia që banka të pësojë humbje financiare si rezultat i ndryshimeve të normave referencë të interesit për instrumentet me karakteristika të ngjashme për nga maturitetin ose koha, deri në ndryshimin e ardhshëm të normës së interesit;

d) “Rreziku i opsioneve” është mundësia që banka të pësojë humbje financiare si rezultat i opsioneve të përfshira në pozicione të ndjeshme ndaj normës së interesit (për shembull kreditë me një opion shlyerjeje të hershme, depozitat me opion tërheqjen e hershme etj.);

e) “Libri i tregtueshëm” përbëhet nga pozicionet në instrumentet financiare të mbajtura me qëllim tregtimi ose për të mbrojtur elemente të tjera të librit të tregtueshëm, me kusht që këto instrumente të jenë të çliruara nga çdo lloj klauzole/dispozite kufizuese, për sa i përket tregtueshmërisë së tyre, ose aftësisë së tyre për t’u mbrojtur tërësisht;

f) “Libri i bankës” përbëhet nga zërat e bilancit dhe zërat jashtë bilancit të një banke, përveç atyre që konsiderohen si pozicione të librit të tregtueshëm;

g) “Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit” është vlera aktuale e të gjitha flukseve monetare neto, të pritshme, të pozicioneve të librit të bankës (për shembull, flukset e pritshme të pasasë së një aktivi të bankës, të reduktuara nga flukset e pritshme të pasasë së një pasivi të bankës);

h) “Monedha kryesore” është çdo lloj monedhe që përbën më shumë se 5% të totalit të aktiveve të bilancit;

i) “Shock-u standard i normës së interesit” është zhvendosja paralele, pozitive apo negative, në kurbën referencë të kthimit (yield-it), prej 200 pikësh bazë;

j) “Pikë bazë” është njësia e barabartë me një të qindtat e 1%.

Neni 5 **Kërkesa për sistemin e administrimit të rrezikut të normës së interesit në librin e bankës**

1. Bankat krijojnë dhe zhvillojnë sistemin për administrimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës, të përshtatshëm me natyrën, vëllimin, kompleksitetin e veprimtarisë dhe profilin e rrezikut të tyre.

2. Bankat, në zbatim të kërkesës së pikës 1 të këtij neni, hartojnë dhe miratojnë strategjinë, politikën dhe aktet e brendshme rregullative për administrimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës, si dhe sigurojnë zbatimin në vazhdimësi të tyre.

3. Bankat krijojnë struktura organizative të përshtatshme, me linja autoriteti dhe përgjegjësie të përcaktuara saktë, të qarta dhe të ndara në mënyrë jo të interpretueshme ndërmjet punonjësve, të cilat sigurojnë pavarësinë e funksionit të administrimit të rrezikut të normës së interesit nga funksioni i krijimit të pozicioneve, që mbartin rrezik të normës së interesit në librin e bankës, si dhe kushte teknike për matjen, monitorimin dhe kontrollin e këtij rreziku (rrezikut të normës së interesit në librin e bankës).

4. Bankat krijojnë një sistem për matjen e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës, që siguron mbulimin e të gjitha burimeve të rrezikut të normës së interesit.

5. Bankat krijojnë një sistem për raportimin e ekspozimit ndaj rrezikut të normës së interesit në librin e bankës, i cili është i pavarur nga funksioni i krijimit të pozicioneve që mbartin rrezik të normës së interesit në librat e bankës dhe përfshin edhe raportimin e rregullt te drejtuesit ekzekutivë, te punonjësit ose organet e bankës, të ngarkuar me matjen, monitorimin dhe kontrollin e këtij rreziku (rrezikut të normës së interesit në librin e bankës).

6. Bankat përcaktojnë supozime të vlefshme për sistemin e administrimit të rrezikut të normës së interesit, të cilat janë të përshtatshme, të dokumentuara dhe të qëndrueshme në kohë.

7. Bankat sigurojnë që çdo ndryshim i rëndësishëm në këto supozime të dokumentohet, të shpjegohet dhe të miratohet nga drejtimi ekzekutiv i bankës.

8. Bankat krijojnë një sistem kontrolli të brendshëm për procesin e administrimit të rrezikut të normës së interesit në librin e bankës.

9. Bankat kryejnë, minimalisht një herë në vit, stress-test-e lidhur me rrezikun e normës së interesit në librin e bankës dhe përdorin rezultatet e testeve të tilla në vendimmarrjet dhe në rishikimin e politikave, të akteve të brendshme rregullative dhe limiteve/kufijve, lidhur me këtë rrezik (rrezikun e normës së interesit).

10. Bankat, në kryerjen e stress-teste-ve, marrin në konsideratë të gjitha burimet e rëndësishme të rrezikut të normës së interesit.

Neni 6

Burimet/format e rrezikut të normës së interesit

1. Bankat vlerësojnë burimet/format e ndryshme të rrezikut të normës së interesit, të cilat mund të ndikojnë negativisht në të ardhurat (të ardhurat neto nga interesat) ose ekspozimin në librin e bankës.

2. Burimet/format e rrezikut të normës së interesit përfshijnë:

- a) rrezikun e riçmimit;
- b) rrezikun e kurbës së kthimit;
- c) rrezikun bazë; dhe
- d) rrezikun e opsioneve.

KREU II

METODAT E LLOGARITJES SË EKSPOZIMIT NDAJ RREZIKUT TË NORMËS SË INTERESIT NË LIBRIN E BANKËS

Neni 7

Kërkesa të përgjithshme

1. Bankat, për qëllime të llogaritjes së ekspozimit ndaj rrezikut të normës së interesit në librin e bankës, përdorin metodën e vlerësimit të ndryshimit në ekspozimin e librit të bankës, duke aplikuar një shock standard të normës së interesit në pozicionet e librit të bankës, në të gjitha monedhat kryesore individualisht, dhe në monedhat të tjera mbi baza të agreguara.



2. Bankat, për qëllime të llogaritjes sipas metodës së vlerësimit të ndryshimit të ekspozimit të librit të bankës, shpërndajnë pozicionet e ndjeshme ndaj normës së interesit, në 14 intervale kohore, siç përcaktohet në tabelën nr. 1 të këtij udhëzimi.

3. Bankat shpërndajnë pozicionet me normë interesi fikse në intervale kohore, sipas maturitetit të mbetur, dhe pozicionet me normë interesi të ndryshueshme në intervale kohore, sipas kohës, deri në ndryshimin e ardhshëm të normës së interesit.

4. Bankat përdorin peshat e ponderuara të përcaktuara në tabelën nr. 1 të këtij udhëzimi, të cilat llogariten si prodhim i shock-ut të normës së interesit prej 200 pikësh bazë (ose 2%) me kohëzgjatjen e modifikuar (*estimated modified duration*) për çdo interval kohor.

5. Bankat, në rastet që përdorin metodën e vlerësimit të ndryshimit në ekspozimin e librit të bankës, ndjekin hapat e mëposhtëm:

a) mbledhin, për çdo monedhë kryesore mbi baza individuale dhe për të gjitha monedhat e tjera mbi baza të agreguara, pozicionet e aktiveve dhe pasiveve dhe instrumenteve financiare derivative (ose zërat e aktiveve dhe pasiveve jashtë bilancit), për secilin interval kohor, me qëllim llogaritjen e pozicionit neto për çdo interval;

b) shumëzojnë pozicionin total neto të llogaritur sipas shkronjës “a” të këtij paragrafi, për çdo interval kohor, me peshat e përcaktuara në tabelën nr. 1 të këtij udhëzimi, për çdo monedhë kryesore mbi baza individuale dhe për të gjitha monedhat e tjera mbi baza të agreguara;

c) mbledhin të gjitha pozicionet e ponderuara, të llogaritura për të gjitha intervalet kohore, me qëllim llogaritjen e pozicionit neto në blerje (*long*) ose në shitje (*short*) për çdo monedhë kryesore mbi baza individuale dhe për të gjitha monedhat e tjera mbi baza të agreguara;

d) mbledhin pozicionet neto në blerje (*long*) dhe në shitje (*short*) për të gjitha monedhat, me qëllim llogaritjen e pozicionit total neto të ponderuar në librin e bankës.

6. Pozicioni total neto i ponderuar në librin e bankës, që përcaktohet në shkronjën “d” të pikës 5 të këtij neni, shprehet në vlerë/shumë absolute dhe do të përfaqësojë ndryshimin në ekspozimin e librit të bankës, si rezultat i aplikimit të shock-ut standard të normës së interesit.

7. Bankat llogarisin raportin e ndryshimit të ekspozimit në librin e bankës ndaj kapitalit rregullator, në përqindje. Ky raport nuk duhet të tejkalojë nivelin prej 20%.

Neni 8

Instrumentet financiare derivative

Bankat, në rastin kur përdorin një instrument financiar derivativ të librit të bankës, për të administruar rrezikun e normës së interesit në librin e bankës, e përfshijnë këtë instrument (financiar derivativ) në llogaritjen e raportit të ndryshimit në ekspozimin në librin e bankës ndaj kapitalit rregullator.

Neni 9

Kërkesa raportuese

1. Bankat raportojnë në Bankën e Shqipërisë në baza 3 (tre)- mujore, sipas formularëve nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3 të aneksit 2 të këtij udhëzimi, pjesë e Sistemit Raportues të Unifikuar.

2. Bankat raportojnë mbi ekspozimet ndaj rrezikut të normës së interesit në librin e bankës, mbi baza individuale dhe të konsoliduara, të cilat konsiderojnë raportimin mbi baza individuale për monedhat kryesore dhe për të gjitha monedhat e tjera mbi baza të agreguara.

KREU III

DISPOZITA TË FUNDIT

Anekset 1 dhe 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi janë pjesë përbërëse e tij.

Aneks 1

Tabela nr. 1

Peshat e ponderimit sipas intervaleve kohore (<i>time band</i>)				
Intervali kohor	Mesi i intervalit kohor	Kohëzgjatja e modifikuar	Ndryshimi i parashikuar në kthim/përfitim (<i>yield</i>)	Peshat e ponderimit
(1)	(2)	(3)	(4)	(5) = (3)*(4)
menjëherë (<i>at sight</i>)	0	0	200 bp	0.00%
Deri në 1 muaj	0.5 muaj	0.04 vite	200 bp	0.08%
1 - 3 muaj	2 muaj	0.16 vite	200 bp	0.32%
3 - 6 muaj	4.5 muaj	0.36 vite	200 bp	0.72%
6 - 12 muaj	9 muaj	0.71 vite	200 bp	1.43%
1 - 2 vite	1.5 vite	1.38 vite	200 bp	2.77%
2 - 3 vite	2.5 vite	2.25 vite	200 bp	4.49%
3 - 4 vite	3.5 vite	3.07 vite	200 bp	6.14%
4 - 5 vite	4.5 vite	3.85 vite	200 bp	7.71%
5 - 7 vite	6 vite	5.08 vite	200 bp	10.15%
7 - 10 vite	8.5 vite	6.63 vite	200 bp	13.26%
10 - 15 vite	12.5 vite	8.92 vite	200 bp	17.84%
15 - 20 vite	17.5 vite	11.21 vite	200 bp	22.43%
Mbi 20 vite	22.5 vite	13.01 vite	200 bp	26.03%



Aneks 2

Formulari nr. 1 Ndryshimi në ekspozimin e librit të bankës, për zërat me Normë Interesi Fikse (NIF)

Forma FIR	Ndryshimi në vlerën e ekspozimit në librin e bankës për zërat me norma fikse interesi															Emri i Bankës / institucionit të kredisë:				
																Modeli i raportimit: Data:				
	Zonat kohore																			
Zëra të ndjeshëm ndaj ndryshimit të normave të interesit në librin e bankës - norma fikse e interesit	Monedha	në të parë	deri në 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-2 vite	2-3 vite	3-4 vite	4-5 vite	5-7 vite	7-10 vite	10-15 vite	15-20 vite	20+ vite					
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15					
BILANCI																				
AKTIVET																				
1 Arkat dhe Banka Qëndrore																				
2 Bono thesari dhe bono të tjera të pranueshme për refinancim me bankën qëndrore																				
3 Llogari rrjedhëse me bankat dhe Institucione të tjera financiare																				
4 Depozita me bankat dhe institucione të tjera financiare																				
Depozita pa afat																				
Depozita me afat																				
5 Hua për bankat dhe institucione të tjera financiare																				
6 Të tjera nga bankat dhe institucionet financiare																				
7 Hua dhe paradhënie minus provigjone																				
8 Letrat me vlerë																				
Letra me vlerë të vendosjes																				
Letra me vlerë të investimit																				
Angazhime të bonove dhe letrave me vlerë të tjera për t'u marrë																				
9 Interesa pjesëmarrës																				
Në banka dhe institucione të tjera financiare																				
Të tjera																				
TOTALI I AKTIVEVE																				

(-) PASIVET													
1	Banka Qëndrore												
2	Reverse repo/ Marrëveshjet e rishitjes repo												
3	Llogari rrjedhëse nga bankat dhe institucione të tjera financiare												
4	Depozita nga bankat dhe institucione të tjera financiare												
	Depozita pa afat												
	Depozita me afat												
5	Hua marrë nga bankat dhe institucione të tjera financiare												
6	Të tjera nga bankat dhe institucionet financiare												
7	Veprime me klientët												
	Llogari rrjedhëse												
	Llogari depozitash pa afat												
	Llogari depozitash me afat												
8	Veprime me administratën publike												
9	Detyrimet nga bonot dhe letra te tjera me vlere												
10	Fonde rezervë specifike												
11	Borxhi i varur												
	TOTAL I PASIVEVE												
	Pozicioni neto i Bilancit												
	Zërat jashtë bilancit												
	Zërat jashtë bilancit AKTIVET												

[illegible]

Formulari nr. 2 Ndryshimi në ekspozimin e librit të bankës, për zërat me Normë Interesi të Ndryshueshme (NIN)

Forma VIR		Ndryshimi në vlerën e ekspozimit në librin e bankës për zërat me norma te ndryshueshme interesi												Emri i Bankës / institucionit të kredisë: Modeli i raportimit: Data:	
		Time zones													
		Monedha		Time zones											
		në të parë		Time zones											
		1		Time zones											
		2		Time zones											
		3		Time zones											
		4		Time zones											
		5		Time zones											
		6		Time zones											
		7		Time zones											
		8		Time zones											
		9		Time zones											
		10		Time zones											
		11		Time zones											
		12		Time zones											
		13		Time zones											
		14		Time zones											
		15		Time zones											
BILANCI															
AKTIVET															
1	Arkat dhe Banka Qëndrore														
2	Bono thesari dhe bono të tjera të pranueshme për refinancim me bankën qëndrore														
3	Llogari rrjedhëse me bankat dhe institucione të tjera financiare														
4	Depozita me bankat dhe institucione të tjera financiare														
	Depozita pa afat														
	Depozita me afat														
5	Hua për bankat dhe institucione të tjera financiare														
6	Të tjera nga bankat dhe institucionet financiare														
7	Hua dhe paratënie														
	minus provigjone														
8	Letrat me vlerë														
	Letra me vlerë të vendosjes														
	Letra me vlerë të investimit														
	Angazhime të bonove dhe letrave me vlerë të tjera për t'u marrë														
9	Interesa pjesëmarrës														
	Në banka dhe institucione të tjera financiare														
	Të tjera														
TOTALI I AKTIVEVE															



(-) PASIVET																
1	Banka Qëndrore															
2	Reverse repo/ Marrëveshjet e rishtitjes repo															
3	Llogari rrjedhëse nga bankat dhe institucione të tjera financiare															
4	Depozita nga bankat dhe institucione të tjera financiare															
	Depozita pa afat															
	Depozita me afat															
5	Hua marrë nga bankat dhe institucione të tjera financiare															
6	Të tjera nga bankat dhe institucionet financiare															
7	Veprime me klientët															
	Llogari rrjedhëse															
	Llogari depozitash pa afat															
	Llogari depozitash me afat															
8	Veprime me administratën publike															
9	Detyrimet nga bonot dhe letra të tjera me vlerë															
10	Fonde rezervë specifike															
11	Borxhi i varur															
	TOTAL I PASIVEVE															
	Pozicioni neto i Bilancit															
	Zërat jashtë bilancit															
	Zërat jashtë bilancit AKTIVET															

[illegible]



Instruksiione të përgjithshme

1. Bankat, në plotësimin e formularëve të raportimit, konvertojnë në lekë, shumën e shprehur në monedhë të huaj, duke zbatuar kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në fuqi në datën e raportimit.
2. Bankat përfshijnë në formularët e raportimit, ekspozimet ndaj rrezikut të normave të interesit të përfshira në librin e bankës, të cilat vlerësohen të ndjeshme ndaj ndryshimeve të këtyre normave.

Shënime shpjeguese: Formulari i raportimit nr. 1 dhe nr. 2

1. Bankat paraqesin në formularin nr. 1 zërat e bilancit dhe jashtë bilancit me normë fikse interesi, të shpërndara sipas intervaleve kohore, në përputhje me maturitetin e mbetur;
2. Bankat paraqesin në formularin nr. 2, zërat e bilancit dhe jashtë bilancit me norma të ndryshueshme interesi, të shpërndara sipas intervaleve kohore, në përputhje me kohën e mbetur deri në ndryshimin e ardhshëm të normës së interesit;
3. Bankat plotësojnë formularët nr. 1 dhe nr. 2, në varësi të llojit të normës së interesit, për çdo monedhë kryesore mbi baza individuale dhe për të gjitha monedhat e tjera mbi baza të agreguara;
4. Bankat, për qëllime të llogaritjes së pozicionit neto "pozicioni total neto" për çdo interval, mbledhin aktivet dhe pasivet (pozicionet brenda dhe jashtë bilancit), duke konsideruar shenjat që i korrespondojnë çdo intervali kohor (bankat, për qëllime të llogaritjes së pozicionit total neto, konsiderojnë pozicionet e aktiveve me shenjë pozitive (+) dhe pozicionet e pasiveve me shenjë negative (-);
5. Bankat, për qëllime të llogaritjes së pozicionit të ponderuar për çdo interval, shumëzojnë pozicionin total neto, të llogaritur me peshat e dhëna në formularët e raportimit nr. 1 dhe nr. 2, në rreshtin "peshat";
6. Bankat, për qëllime të llogaritjes së pozicionit neto në blerje (*long*) ose në shitje (*short*) "pozicioni neto i ponderuar sipas monedhës" për çdo lloj norme interesi, sipas monedhave, mbledhin pozicionet e ponderuara, të llogaritura për çdo interval;

7. Bankat, në rastet e pozicioneve me maturitet të papërcaktuar ose për të cilat nuk njihet periudha e ndryshimit të normës së interesit apo kjo periudhë nuk mund të përcaktohet me siguri, bëjnë shpërndarjen e pozicioneve në intervale kohore të përshtatshme, duke u bazuar në eksperiencën e tyre të mëparshme mbi sjelljen e këtyre pozicioneve;
8. Bankat nuk i konsiderojnë si të ndjeshme ndaj ndryshimeve të normës së interesit, zërat e bilancit të tilla si cash-i, mjetet e qëndrueshme, kapitali i aksionerëve dhe zëra të tjerë të ngjashëm, si dhe zërat jashtë bilancit të tilla si garancitë, letër-kreditë, linjat e papërdorura të kredisë dhe zërat e tjerë të ngjashëm jashtë bilancit;
9. Bankat shpërndajnë llogaritë rrjedhëse dhe depozitat pa afat, në pasiv të bilancit, sipas mënyrës së përcaktuar më poshtë:
 - a. në intervalin kohor “*at sight*” (menjëherë/pa afat) vendoset një përqindje fikse (25%) e llogarive rrjedhëse dhe depozitave pa afat;
 - b. në intervalet kohore nga “deri në 1 muaj” në “4-5 vjet” vendosen në mënyrë proporcionale me numrin e muajve që përmban intervali¹, llogaritë e mbetura (75%) e atyre të përfshira në shkronjën “a” më sipër;
10. Rezerva e detyrueshme në lekë pranë Bankës së Shqipërisë raportohet në formularin e raportimit nr. 2, në zonën kohore “deri në 1 muaj”, ndërsa rezerva e detyrueshme në monedhë të huaj konsiderohet si zë (pozicion) jo i ndjeshëm ndaj rrezikut të normës së interesit;
11. Bankat shpërndajnë vendosjet në letra me vlerë të borxhit sipas intervaleve kohore, në përputhje me mënyrën e rënë dakord në marrëveshjen/et respektive;
12. Bankat shpërndajnë zërat (kreditë) me probleme në intervalin kohor “2-3 vjet” për vlerën e tyre neto, pas zbritjes së fondeve rezervë të krijuara në datën e raportimit;
13. Bankat shpërndajnë aktivitet dhe pasivet me pagesa me këste, sipas intervaleve kohore në përputhje me planin e shlyerjes;
14. Bankat shpërndajnë derivativët sipas intervaleve që i korrespondojnë instrumenteve, mbi bazën e të cilëve ata (derivativët) janë emetuar;

¹ P.sh. në intervalin kohor “deri në 1 muaj” do të paraqitet 1/60 e shumës së mbetur dhe në intervalin kohor “6 deri në 12 muaj” 6/60 e saj.

15. Bankat raportojnë instrumentet financiare të strukturuar brenda apo jashtë bilancit, të ndarë sipas elementeve të tyre përbërëse, duke përfshirur ato, të cilat për qëllime mbikëqyrëse, bëjnë pjesë në portofolin e tregtueshëm. Opsionet, pavarësisht natyrës së tyre (të tilla si: e drejta e shlyerjes së parakohshme, opsioni i ndryshimit të normës së interesit nga normë fikse në të ndryshueshme etj.), shpërndahen sipas intervaleve bazuar në vlerën ekuivalente *delta*².
16. Bankat trajtojnë zërat e aktiveve dhe pasiveve me norma interesi të ndryshueshme dhe që përbajnë një normë minimale ose maksimale ("floor" ose "cap"), si kombinime të një zëri me normë të ndryshueshme dhe një opsioni të tipit "floor" ose "cap". Kështu, një kredi me normë interesi të ndryshueshme dhe me normë minimale "floor" për t'u paguar nga klienti, do të paraqitet si një kombinim i a) një kredie me normë të ndryshueshme (për t'u shpërndarë në shportën përkatëse sipas datës së rishikimit të normës së interesit) dhe b) një opsioni të blerë "floor" në një pozicion të blerë për normë fikse dhe në shitje për normë të ndryshueshme³.
17. Bankat, për zërat e aktiveve apo pasiveve me norma interesi fikse për një numër të caktuar vitesh, të cilat për pjesën tjetër të periudhës (sipas kontratës) mbartin norma interesi të ndryshueshme, do të paraqiten në formularin nr. 2 të zërave me normë interesi të ndryshueshme⁴. Për paraqitjen në këtë formular, kohë e mbetur deri në ndryshimin e ardhshëm të normës së interesit do të konsiderohet periudha kohore ndërmjet datës së raportimit dhe datës së parë kur kjo normë do të rishikohet.

² "Vlera ekuivalente "delta" është vlera e tregut e instrumentit bazë, shumëzuar me parametrin (koeficientin) delta. Ky i fundit (parametri ose koeficienti delta) përfaqëson ndryshimin e pritshëm në çmimin e një opsioni, si rezultat i ndryshimit në çmimin e instrumentit bazë të tij, dhe llogaritet nga bursa ose sipas modeleve standarde të tregut ose sipas modeleve të brendshme bankës.

³ *Shembull:* Supozohet një kredi me afat maturimi pesë vjet, e akorduar në shumën 500 lekë, me kështë vjetore 100 lekë, me normë të ndryshueshme çdo vit dhe me opsionin që norma e interesit nuk mund të bjerë nën X përqind. Vlera delta e opsionit supozohet e barabartë në çdo kështë.

Hipoteza A - delta 0%: në këtë rast, kredia do të shpërndahet (alokohet) për shumën 500 lekë në intervalin kohor të rishikimit "6-12 muaj" dhe nuk do të konsiderohen pozicione në blerje apo në shitje për opsionin;

Hipoteza B - delta ekuivalente 50%: në këtë rast, kredia në shumën 500 lekë do të shpërndahet (alokohet) në intervalin kohor që i korrespondon datës së rishikimit të normës së interesit "6-12 muaj". Opsioni në vlerën 50 (=100*50%) do të shpërndahet (alokohet) në 5 pozicione në blerje, në intervale kohore "6-12 muaj", "1-2 vjet", "2-3 vjet", "3-4 vjet" dhe "4-5 vjet", dhe një pozicion në shitje për shumën 250, në intervalin kohor që i përkon datës së rishikimit, pra "6-12 muaj".

